

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri anëtarë, në çështjen juridike të paditësit M. A. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson av. B. A. nga Prishtina, kundër të paditurës Qendra e Studentëve në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Sh.H. zyrtar ligjor në Departamentin për Çështje Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës, për shkak të kompensimit të pagave, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4051/2014 datë 9.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.11.2017, mori këtë,

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4051/14 datë 9.06.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4051/14 të dt.9.06.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3280/12 dt.5.06.2014, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpapia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia njoh të drejtën e kompensimit të të ardhurave personale për periudhën 3.03.1992 deri më 31.12.1999, sipas raportit të ekspertit financiar, me kamatë ligjore, në afat prej 15 ditësh pas

plotfuqishmërisë së aktgjykimit, me kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm si dhe shpenzimet e procedurës sipas përcaktimit të gjykatës.

Me pjesën e II, ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor paditësi ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni dhe aktgjykimet, ai i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i gjykatës së shkallës së dytë të prishen dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, midis palëve ndërgjyqësore nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë punëtor, në vendin e punës kuzhinier në Qendrën e Studentëve në Prishtinë, të para luftës e cila ishte në kuadër të Universitetit të Prishtinës, se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendimin e drejtorit të atëhershëm të QS-së, nr.200 dt.3.03.1992, se pas përfundimit të luftës në Kosovë, paditësi është kthyer në vendin e punës. Nga aktgjykimi i gjykatës komunale në Prishtinë Pl.nr.4492/92 dt.30.09.1996 rezulton se është anuluar vendimi i drejtorit të QS-së, i sipër cekur, dhe është detyruar QS që paditësin ta kthejë në punë me detyrat e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, i cili aktgjykim ka marrë formën e prerë me dt.22.11.1996. Poashtu, nuk ishte kontestues fakti se paditësi nuk ka realizuar kompensimin e të ardhurave personale për periudhën kontestuese 3.03.1992-31.12.1999. Midis palëve ndërgjyqëse ishte kontestues fakti se tani e paditura Qendra e Studentëve a e ka legjitimitetin real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë. Gjykata e shkallës së parë, nga shkresat e lëndës dhe provat e zhvilluara, ka vlerësuar se pala e paditur nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë. Për legjitimitet real bëhet fjalë kur kihet parasysht pala në kuptimin materialo-

juridik dhe lidhja materialo-juridike e subjekteve të raportit juridik kontestues dhe subjekteve që në padi janë treguar si paditës dhe i paditur.

Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se në bazë të Rezolutës së KS të OKB-së nr.1244 në Kosovë është krijuar një realitet i ri juridik-politik. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.1/1999 dhe 24/1999 dhe Rregulloreve tjera të UNMIK-ut "gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm-PSPP." Nga kjo Rregullativë, rezulton se të gjitha organet administrative të krijuara nga UNMIK-u rrjedhimisht edhe nga Qeveria e Kosovës nuk janë trashëgimtare të ish organeve administrative dhe të organeve tjera të cilat para lufte kanë ekzistuar në Kosovë. Prandaj, edhe Qendra e Studentëve nuk është trashëgimtare e Qendrës së Studentëve të paraluftës, sepse me vendosjen e UNMIK-ut në Kosovë është ndërprerë kontinuiteti i ish organeve dhe organizatave që kanë ushtruar veprimtari publike apo shoqërore që në rastin konkret ish QS ka ushtruar veprimtarinë dhe ka qenë në kuadër të Ministrisë së Arsimit të RS.

Duke u nisur nga gjendja e këtyre faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ndaj, edhe e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të sajë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ndaj, ka vendosur se ankesa e paditësit është e pathemeltë dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës së parë dhe shkallës së dytë, kur nga arsyet e sipër theksuara, kanë vendosur për refuzimin e kërkesëpadsisë së paditësve. Aktgjykimet e tyre nuk janë të përfshira me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë, kujdeset sipas detyrës zyrtare. Në revizionin e paditësit nuk specifikohen individualisht shkeljet e pretenduara, thuhet në mënyrë të përgjithësuar, pa i konkretizuar se cilat janë ato,

ndaj, pretendimet e tilla për shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nuk mund ta vënë në dyshim aktgjykimin e goditur dhe si të tilla u refuzuan të pathemelta.

Po ashtu, aktgjykimet e lartcekura, nuk janë përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, siç pretendohet nga revizioni. Me të drejtë, ceket në aktgjykimin e gjykatave të instancës më të ulët, pas çlirimit, në bazë të Rezolutës së KS të OKB-së 1244 dhe Rregullores së UNMIK-ut 1999/1 dhe 1999/24 është krijuar në realitet i ri. Ndërkaq, me dispozitën e nenit 1 të kësaj Rregulloreje është paraparë se i gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv ushtrohet nga UNMIK-u dhe përfaqësuesi special i KB. Ndërsa, si ligje në fuqi në Kosovë, përveç tjerash, në rend të parë janë rregulloret e shpallura nga PSPP dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. Me rregulloret e UNMIK-ut janë themeluar të gjitha institucionet legjislative, ekzekutive dhe të administratës së në nivelin qendror, ashtu edhe në vetëqeverisjen e komunave të Kosovës. Sipas këtyre rregulloreve, veç tjerash, as Qendra e Studentëve e pas luftës, nuk është pasardhëse juridike e Qendrës së Studentëve të para luftës (nuk ka midis tyre suksesion juridik), prandaj, të paditurës, Qendrës së Studentëve i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë kontest, nga se kjo e paditur, nuk ka qenë në raport materialo-juridik civil a materialo-juridik të punës me paditësin, nga i cili raport paditësi nxjerrë të drejtën e tij. Pra, e paditura nuk është pjesëmarrëse e raportit materialo –juridik nga i cili ka lindur ky kontest. Legjitimiteti real aktiv ose pasiv është raporti i palëve ndërgjyqëse ndaj së drejtës subjektive, për të cilën ka filluar kontesti. Ndaj, me të drejtë rrjedhë konstatimi se midis Qendrës së Studentëve të para luftës dhe Qendrës së Studentëve të pas luftës nuk ekziston suksesioni juridik, nga këtu edhe mungesa e legjitimitetit real pasiv të së paditurës.

Nuk qëndron as pretendimi i revizionit lidhur me” çështjen e gjykuar”, për shkak të ekzistimit të aktgjykimeve të sipër cekura të dt.3.09.1996 dhe dt.22.11.1996, sepse aktgjykimet e sipër përmendura, veç tjerash, kanë të bëjnë me një bazë (kërkesë) tjetër, vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të sipër cekur mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ndërsa, këtu. në rastin konkret kemi të bëjmë me padinë për kompensimin e pagave për periudhën e sipër përmendur. Ndërkohë që, për t’u konsideruar një çështje, si “çështje e gjykuar-res iudicata” kërkohet që kumulativisht të plotësohen këto kushte: Identiteti (njëjtësia) i palëve, identiteti i

kërkesës, identiteti i gjendjes faktike dhe që kontesti të jetë zhvilluar dhe përfunduar në procedurën kontestimore, gjë që këtu, nuk është ky rast.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.230/2017 datë 20.11. 2017

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc.Muhamet Rexha
